

ÇËSHTJA E ADRIATIKUT NË KONFERENCËN E PARISIT 1919-1920

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË FAKULTETIN FILOZOFIK NË
DEPARTAMENTIN E HISTORISË

NGA

FEJZ FEJZULLAHI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

SHTATOR, 2021

EKspoze e Temës

Çështja e Adriatikut në Konferencën e Parisit 1919-1920

Mentor:

Prof.Dr. Ibrahim Gashi

Kandidati:

Fejz Fejzullahi

Një nga ngjarjet me rëndësi në historinë shqiptare të periudhës ndërmjet dy luftërave botërore dhe në përgjithësi është Konferenca e Paqes së Parisit 1919-1920, e cila për nga pesha e vendimeve të saja si dhe reflektimi i saj në rrjedhat e mëtejshme evropiane dhe botërore, ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për historinë e kombit shqiptar, por edhe të popujve të tjerë të Evropës. Për gjashtë muaj të vitit 1919, me të vërtetë Parisi ishte kryeqyteti i botës. Konferenca e Paqes ishte çështja më e rëndësishme e botës, ndërkaq paqebërësit konsideroheshin me të drejtë si njerëzit më të fuqishëm të saj. Përfundimi i Luftës së Parë Botërore, edhe Lëvizjen Kombëtare Shqiptare e gjeti me një program të qartë të orientuar në dy parime kryesore: Rikonfirmimin e Pavarësisë së shtetit shqiptar të njohur ndërkombëtarisht në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913; si dhe parimi i dytë ishte rishikimi i kufijve shtetërorë me qëllim përfshirjen e viseve të tjera shqiptare brenda shtetit shqiptar.

Punimi trajton me kujdes rrethanat e zhvilluar gjatë kësaj periudhe, si një ngjarje me një peshë mjaft të madhe në aspektin historik për botën, por në veçanti për shqiptarët. Ngjarje me një peshë mjaft të madhe historike për shqiptarët ishte edhe çështja e Adriatikut, si një prej çështjeve të përgjithshme politike të trajtuara në Konferencën e Paqes së Parisit. Qëllimi i këtij punimi është që të dihet gjendja faktike e zhvillimeve të Konferencës së Paqes së Parisit, dhe në veçanti të dihen zhvillimet politike si dhe vendimet që janë marrë në këtë Konferencë nga fuqitë e mëdha të kohës. Tema përfshin një periudhë që në aspektin historik dhe në aspektin koherent është një ngjarje e shkurtër, mirëpo e mbushur me vendime që do t'i jepeshin një kahe krejt tjetër botës. Vendimet e kësaj Konference dikë dëmtuan mjaft shumë, mirëpo edhe në anën tjetër pati shtete që përfituan nga kjo ngjarje mjaft me peshë. Vendimet për botën, si dhe në veçanti për shqiptarët ishte arsyeja që më shtyu të punoja dhe të trajtoja në aspektin shkencor këtë lloj distracioni. Me të vërtetë Parisi ishte bërë kryeqyteti i botës gjatë kësaj periudhe, ku në këtë vend u morën vendime mjaft të mëdha për vendet e

ndryshme të botës. Vendosja e armëpushimit dhe fillimi i Konferencës së Paqes në Paris e gjetën Evropën në një situatë të ndryshme nga ajo e paraluftës. Rrethanat kishin krijuar raporte të reja në strukturën politike, ishin vendosur ekuilibra të kundërt me ato paraprake ishin futur në skenën evropiane ShBA-të, ishte krijuar një grup i tërë shtetesh të reja, si dhe ishin paraqitur një varg doktrinash të reja lidhur me sistemin ekonomik-shoqëror, me sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare me të drejtën ndërkombëtare, si dhe me diplomacinë. Një rol mjaft të madh në këtë Konferencë luajti Presidenti amerikan Uillson. Nga të gjitha idetë që presidenti amerikan kishte sjellë në Evropë, koncepti i vetëvendosjes ishte dhe ka mbetur ndër më të kundërshtuarit dhe më të errëtit. Gjatë Konferencës së Versajës shefi i misionit amerikan në Vjenë disa herë e kishte pyetur Parisin dhe Uashingtonin për ta shpjeguar këtë term. Nga kjo konkludohet se nuk ishte asnjëherë e lehtë të përcaktohet se çka kishte ndërmend në të vërtetë Presidenti Uillson. Në anën tjetër, Kongresi Kombëtar i Lushnjës përbën një ngjarje me rëndësi të madhe historike në procesin e ngritjes së institucioneve në shtetin shqiptar. Punimet e këtij Kongresi filluan më 21 janar 1920 dhe përfunduan më 31 janar 1920. Në këtë Kongres kemi miratimin e një akti kushtetues që kishte të bënte me pavarësinë e plotë të Shqipërisë.

Punimi është i ndarë në tre kapituj në të cilët është trajtuar organizimi, vendimet e marra në këtë Konferencë si dhe rezultatet e kësaj Konference. Në kapitullin e parë janë trajtuar format e organizimit të kësaj Konference, procedurat mbi të cilat ka kaluar deri tek mbajtja e kësaj Konference, si dhe ardhja e personaliteteve me ndikim nga vendet e ndryshme të botës, e në veçanti ardhja e Uillsonit e bëri edhe më të rëndësishëm këtë organizim, ku përmes katërmbëdhjetë pikave të tij pretendonte të paraqiste një program me një moral të ri në politikën botërore.

Kapitulli i dytë përfshin qëndrimet e Fuqive të Mëdha ndaj trojeve shqiptare, si dhe kërkesat e shqiptarëve drejtuar Konferencës, ku këto kërkesa u shprehen nga një delegacion i përbërë nga përfaqësues të Qeverisë së Durrësit, në krye me Turhan Pashë Përmetin-kryetar. Në kuadër të këtij kapitulli trajtohet edhe mbajtja e Kongresit të Lushnjës dhe vazhdon me gjendjen politike në Shqipëri para mbajtjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës dhe përgatitjet për mbajtjen e këtij Kongresi, e më pas jepen informacione për mbajtjen e këtij Kongresi dhe vendimet e marra në të.

Pastaj kemi edhe kapitullin e tretë, ku bëhet fjalë për veprimtarinë e qeverisë së Sylejman Delvinës. Sikur tek kapitujt e mëparshëm edhe kapitulli i tretë është i ndarë në tre

nëntituj. Në nëntitullin e parë kemi formimin e qeverisë së Sylejman Delvinës dhe fillimin e veprimtarisë së saj, në nëntitullin e dytë bëhet fjalë për Luftën e Vlorës dhe rëndësinë e saj. Pjesa e fundit e këtij kapitulli është rënia e qeverisë së Sylejman Delvinës.

Ndërsa në kapitullin e tretë trajtohen pretendimet e shteteve fqinje ndaj tokave shqiptare, si dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha e në veçanti trajtimi i çështjes së Adriatikut, si njëra prej çështjeve më të përgjithshme politike të trajtuara në Konferencën e Paqes së Parisit. Temë trajtimi mjaft e rëndësishme gjatë këtij kapitulli është edhe anëtarësimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, si rezultat i përpjekjeve të shumta të Republikës së Shqipërisë, ku edhe anëtarësimi i saj u bë në rrethana krejt të jashtëzakonshme pas insistimit të Britanisë së Madhe, insistim i shndërruar në interesa ekonomike e gjeostrategjike. E rëndësishme gjatë trajtimit të këtij kapitulli është edhe përkrahja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Konferencën e Paqes dhe insistimi i saj i vazhdueshëm që Shqipëria të qëndrojë në kufijtë e saj të pranuar në Konferencën e Londrës, ku këta kufijtë më vonë do të njiheshin edhe zyrtarisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Metodat që janë përdorur në realizimin e këtij punimi janë: metoda e analizës dhe metoda e krahasimit. Këto metoda janë përdorur me një objektivizëm mjaft të shprehur, dhe me një gjakftohtësi mjaft të theksuar.

